R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

Datë 20.11.2026

NJOFTIM
Shtesë në rendin e ditës të mbledhjes së radhës

Në mbështetje të nenit 53, pika 2, të nenit 57 pika 2/c të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, të nenit 48, nenit 49, nenit 55, të Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Durrës, Këshilli Bashkiak Durrës,

NJOFTON:

Ditën e martë, datë 24.11.2026, ora 12:00, në mbledhjen e radhës, që do të mbaj Këshilli Bashkiak, do të kemi shtesa në rendin e ditës si më poshtë:

****	MIRATIMI I SHTESAVE NË REND DITE
Pika 6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E Z. GEG ÇELA, SI PËRFITUES I MASËS SË GRANTIT TË RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE KATUND I RI, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 6 NËNTOR 2019, SIPAS PROJEKTIT MODEL
Pika 7. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR VIJIMIN E PROÇEDURËS PËR PRISHJEN E DETYRUAR TË SEKSIONIT 2 (SHTESËS) TË PALLATIT NR.16, RRUGA "JAHJA BALLHYSA", LAGJA NR.17, KODI GIS 3102, DURRËS, PRONË PRIVATE NË ZBATIM TË OPONENCËS TEKNIKE TË HARTUARA NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT
Pika 8. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NR.RENDOR 2 TË ANEKSIT NR.1 MIRATUAR ME VENDIM TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.42, DATË 09.07.2026 "PËR MIRATIMIN E LISTAVE SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË PALLATIN KASTRATI NR. 14, RRUGA "STEFAN DHIMA", NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; PALLATIN NR. 8, RRUGA "STEFAN DHIMA", NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 3; PALLATIN NR. 25/1, RRUGA "HYSEN MYSHKETA",

	NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 3; PALLATIN NR. 18, RRUGA “DAVID SELENICA”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; PALLATIN NR. 52, RRUGA “SELVIA”, NJËSIA ADMINISTRATIVE SUKTH; MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NR. RENDOR 1 TË ANEKSIT NR. 1 “SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 2” TË VKB-SË NR. 79, DATË 29.07.2024, SI DHE MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NR. RENDOR 1 TË ANEKSIT NR. 3 “SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 5” TË VKB-SË NR. 86, DATË 31.08.2020”

Komisionet, që do të shqyrtojnë projektvendimin do të jenë:

Në mbështetje të nenit 33, nenit 34 pika 1, nenit 77 pika 8, të Rregullores së Funksionimit të Këshillit Bashkiak Durrës, anëtarët e Komisioneve të Këshillit Bashkiak pasi shqyrtojnë me njëri tjetrin projektvendimin përkatës, dorëzojnë propozimin e tyre (Raportin) mbi projektvendimin pranë zyrës së Sekretares së Këshillit, sipas grafikut të mëposhtëm.

Datë 24.11.2026

Nr.	Komisionet që shqyrtojnë projektvendimet	Projektvendime pikat e rendit të ditës	Vendi i mbajtjes së mbledhjes	Ora
1.	Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike	**6, 7, 8**	Salla e Këshillit	**10.00**
2.	Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike	**6, 8**	Salla e Këshillit	**10:30**
3.	Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës	**7**	Salla e Këshillit	**11.00**

SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS

Dorina Milja